

Raportit të Performance

Data:	11 mars 2026					
AGJENCIA	Instituti i Kosovës për Administratë Publike					
MINISTRIA PËRGJEGJËSE	Ministria e Punëve të Brendshme					
Misioni i Agjencisë	Instituti i Kosovës për Administratë Publike (IKAP) është përgjegjës për zbatimin e politikave dhe strategjive të trajnimit, aftësimin profesional dhe zhvillimit të kapaciteteve në shërbimin civil dhe administratën publike në përgjithësi.					
Objektivat	Treguesi(t)	Vlera e synuar	Vlera faktike	Rezultatet (Autputet) e planifikuara	Rezultatet (Autputet) e përfunduara (Po/Jo)	Shënim shpjegues
1. Plotësimi i Kornizës Ligjore me legjislacionin dytësorë	<p>Udhëzimi Administrativ nr. XX/2024 për Kushtet e Angazhimit, Kategorizimit dhe Pagesës së Trajnerëve në Institutin e Kosovës për Administratë Publike</p> <p>Hartimi i draftit fillestar;</p> <p>Konsultimi paraprak dhe Konsultimi publik;</p> <p>Shqyrtimi përfundimtar, finalizimi dërgimi për miratim;</p> <p>Miratimi i Projekt</p>	Miratimi i Udhëzimit Administrativ për Kushtet e Angazhimit, Kategorizimit dhe Pagesës së Trajnerëve në IKAP.	Është hartuar drafti final, është dërguar në kabinet të ministrit, por është ndërprerë ky proces.	Miratimi i Udhëzimit Administrativ për Kushtet e Angazhimit, Kategorizimit dhe Pagesës së Trajnerëve në IKAP.	Pjesërisht	Është vendosur përsëri në planin legjislativ të MBP-së për vitin 2026.

	Organizimi i 6 kurseve trajnimit për trajner.	60 trajner të planifikuar për certifikim.	22 trajner të certifikuar.	Do të certifikohen 60 trajner të rinj.	Po (49 janë certifikuar)	6 TpT-të janë realizuar nga IKAP dhe me projekte;
3. Plotësimi i vendeve të lira të punës dhe funksionalizimi i plotë i strukturës së re	<p>Menaxhimi dhe zhvillimi i burimeve njerëzore të pozitave të reja, plotësimi i pozitave të lira.</p> <p>Përgatitje e planit të trajnimeve për aftësimin e stafit me fokus në zhvillimi i aftësive analitike, prezantuese në platforma digjitale.</p> <p>Hartimi i Udhëzuesit për Etikë dhe Integritet në punë.</p> <p>Pajisja e sallave me mjete për zhvillimin e trajnimit interaktiv.</p> <p>Pajisja zyrtare me mjete për punë.</p>	Përfundimi i tërë procesit deri në finalizimin.	<p>Është bërë përshkrimi dhe aprovimi i vendeve të punës.</p> <p>Është kaluar nga struktura e vjetër në strukturën e re.</p> <p>Janë rekrutuar udhëheqësit e divizioneve.</p>	<p>Zhvillimi i procedurave të rekrutimit.</p> <p>Stafi i punësuar, dhe plotësimi i vendeve të lira.</p> <p>Plani i trajnimit,</p> <p>Raporti i trajnimit të stafit të IKAP.</p> <p>Stafi i trajnuar.</p> <p>Udhëzues i vihen stafit në dispozicion.</p> <p>Raporti i nevojave me pajisje për salla të trajnimit.</p> <p>Sallat e pajisura.</p> <p>Raporti i nevojave të stafit.</p>	Po	<p>Pozita e drejtorit ekzekutiv nde është plotësuar.</p> <p>3 pozita të tjera janë plotësuar (drejtor i departamentit dhe dy zyrtarë të lartë).</p> <p>Stafi janë trajnuar.</p>
4. Digjitalizimi i trajnimeve dhe ngritja e cilësisë së trajnimeve .	<p>Së paku tre programe të trajnimit përmes platformës.</p> <p>E gatshme për përdorim në</p>	<p>Identifikimi i trajnimeve përmes platformës.</p> <p>Funksionalizimi dhe përdorimi</p>	1 platformë e gatshme për përdorim dhe realizimin e trajnimeve digjitale.	<p>4 trajnime të zhvilluara përmes platformës.</p> <p>Është nënshkruar MiM me</p>	Po	<p>Është realizuar plotësisht.</p> <p>Është pilotuar platforma dhe ka rezultuar e suksesshme.</p>

	<p>IKAP dhe tek institucionet publike.</p> <p>Udhëzuesit e përfunduar.</p> <p>Raporti nga trajnimet e përfunduara përmes platformës.</p>	<p>i Platformës për trajnime.</p> <p>Hartimi i udhëzuesve për përdorimin e platformës.</p> <p>Trajnimi i nëpunësve civil me programet e caktuara përmes platformës.</p>		<p>institucione për përdorim të platformës.</p> <p>Është hartuar udhëzuesi për përdorim.</p>		<p>Janë vendosur materialet e trajnimit për 4 trajnime.</p>
<p>5. Bashkëpunim me institucionet dhe organizatat partnere.</p>	<p>Plani i hartuar.</p> <p>Raporti nga aktivitetet e caktuara për periudhat kohore.</p> <p>Raporti dhe rezultatet nga punëtoritë e organizuara me institucionet simotra.</p> <p>Raporti nga vizitat realizuara.</p>	<p>Hartimi i planit të trajnimeve në bashkëpunim me institucionet dhe organizatat partnere.</p> <p>Koordinimi i aktiviteteve përmes takimeve të rregullta.</p> <p>Organizimi i tryezave dhe punëtorive të përbashkëta.</p> <p>Realizimi i vizitave studimore me institutet dhe shkollat për administrate publike.</p>	<p>Marrëveshjet e Mirëkuptimit të nënshkruar me institucionet.</p>	<p>Janë organizuar tre punëtori me menaxheret e burimeve njerëzore në nivel vendi;</p> <p>Është hartuar raporti me rekomandime nga punëtoritë.</p> <p>Janë realizuar 4 vizita me karakter bashkëpunimi me institucionet partnere.</p>	<p>Po</p>	<p>Në njërin nga vizitat (Poloni) është nënshkruar Marrëveshje Mirëkuptimi me Shkollën për Administrate Publike.</p>

3. ZBATIMI I PLANIT TË PERFORMANCËS

- Përshkrimi i detajuar i zbatimit të secilit aktivitet sipas Planit të Performancës, duke përfshirë:
 - Aktivitetet që janë zbatuar brenda afatit.
 - Aktivitetet që nuk janë zbatuar dhe arsye të moszbatimit.

4. ANALIZA E PËRFORMANCËS

Sukseset: Aktivitetet e Institutit të Kosovës për Administratë Publike (IKAP) gjatë vitit 2025 pasqyruan një angazhim të thellë për ngritjen e kapaciteteve të administratës publike dhe përmirësimin e shërbimeve për qytetarët e Kosovës. Përmes bashkëpunimeve të frytshme me partnerë ndërkombëtarë dhe institucione vendore, IKAP ka arritur të krijojë një bazë të fortë për zhvillimin profesional të shërbyesve civilë. Trajnimet dhe programet inovative të realizuara këtë vit janë një dëshmi e përkushtimit për modernizimin dhe dixhitalizimin e procesit të trajnimit.

Sfidat: Sigurimi i burimeve të qëndrueshme financiare për realizimin e projekteve të planifikuara; Menaxhimi i kërkesave të larta për trajnime brenda një infrastrukture të kufizuar; Harmonizimi i nevojave të administratës publike me standardet ndërkombëtare të trajnimit; Përballja me rezistencën ndaj ndryshimeve dhe inovacioneve në disa nivele të administratës publike.

Sfide në vete është zhvillimi i data bazës së re të trajnerëve, zhvillimi i një sistemi online më efikas për menaxhimin e rezultateve dhe vlerësimin të trajnimeve, funksionalizimi i ueb-faqes së re, e cila mundëson një qasje më të lehtë për të gjithë shërbyesit civilë dhe më gjerë, zgjerimi dhe krijimi i faqes së IKAP në prezantim të aktivisteve në rrjete sociale.

Plotesim ndyshimi i legjislacionit primar dhe dytësorë, që do mundësonte një sistematizim të mirëfillte, duke kështu eksperteve të IT, Departament për E-mesim, staf për administrim të trajnimeve, zyrtarë të informimit dhe zyrtarë financiar.

5. SHPENZIMI I BUXHETIT

IKAP për çdo vit i ndahet buxhet nga Qeveria, buxheti i cili është i ndarë në tre kategori: paga dhe mëditje, mallra dhe shërbime dhe kategoria komunale. Edhe për vitin 2025, Qeveria ka ndarë buxhet të njëjtë për këto tre kategori dhe atë si në vijim:

- Kategoria paga dhe mëditje buxheti për vitin 2025 ishte 148,975.00€;
- Kategoria mallra dhe shërbime për vitin 2025 ishte 198,714.00€;
- Kategoria komunalit për vitin 2025 ishte 6,500.00€.

IKAP të gjitha shërbimet e ofruar, përjashto kategorinë e komunale i realizon nga kategoria mallra dhe shërbime, duke ndarë shuma për secilin kod veç e veç. Shumë më e madhe (mbi 90%) ndahet për shërbimin e trajnimit, ku përfshihen pagesat e trajnerëve, hartimit të materialit të trajnimit, ushqim dhe pije, mjete të punës për organizimin e trajnimit.

Një pjesë e aktiviteteve, duke përfshirë edhe pagesat e trajnimeve, janë mbuluar nga donatorët, të cilët IKAP paraprakisht ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi. Vlera e financimit të donatorëve kapë shumën prej 55,987.92€.

IKAP për herë të parë pas shumë viteve, arrin të shpenzojë buxhetin në masën 99.96% në kategorinë mallra dhe shërbime.

Planifikimi dhe ekzekutimi i buxhetit të IKAP-it sipas kategorive ekonomike

Kategoria	Planifikimi	Realizimi	Përqindja
Paga dhe mëditje	148,975.00€	148,975.00€	100%

Mallra dhe shërbime	198,714.00€	198,638.00	99.96%
----------------------------	-------------	------------	--------

IKAP të gjitha shërbimet e ofruar, përjashto kategorinë e komunaleve i realizon nga kategoria mallra dhe shërbime, duke ndarë shuma për secilin kod veç e veç. Shumë më e madhe (mbi 90%) ndahet për shërbimin e trajnimit, ku përfshihen pagesat e trajnerëve, hartimit të materialit të trajnimit, ushqim dhe pije, mjete të punës për organizimin e trajnimit (fletore, laps, marker, tabela, stilolaps, etj.).

Procedurat e Prokurimit

IKAP edhe gjatë këtij viti kishte hartuar planin e prokurim, në të cilin ishin të planifikuar tre procedurat të prokurimit.

Që të gjitha janë realizuar dhe mbikëqyrur në çdo aspekt nga ana e IKAP dhe janë si në vijim:

1. Shërbime hoteliere (150,000.00 për tre vit);
2. Pajisje të TI (23,000.00.);
3. Material zyrtare (16,500.00).

6. REKOMANDIMET PËR PËRMIRËSIM

Zhvillimi i Trajnimeve të Qëndrueshme

IKAP synon të avancojë më tej programet e trajnimit për shërbyesit civilë duke u fokusuar në cilësinë, relevancën dhe përshtatjen me nevojat bashkëkohore.

Rritja e Bashkëpunimeve Ndërkombëtare, zgjerimi i partneriteteve me institute dhe Shkolla të Administratës Publike, për të përfituar nga përvojat dhe njohuritë globale.

Dixhitalizimi i Trajnimeve

Vazhdimi i zhvillimit të platformave online dhe përdorimi i teknologjive inovative për të rritur mundësinë dhe efikasitetin e trajnimeve.

Përmirësimi i Infrastrukturës së Trajnimeve. Investimi në pajisje të teknologjisë në sallat e trajnimit dhe krijimi i hapësirave moderne, që i përshtaten metodologjive të reja të mësimdhënies, duke përdorur metoda të avancuara për zhvillimi të trajnimeve, pajisja e pjesëmarrësve me certifikata online, ofrimi i materialeve prezantuese në platformën online.


Vlerësimi i Ndikimit të Trajnimit

Përcaktimi i mekanizmave për të matur ndikimin e trajnimeve në përmirësimin e performancës së administratës publike, zvogëlimi i barrës administrative tek institucionet që ofrojnë shërbime për qytetaret, ofrimi i metodologjisë së mësimdhënës nga eksperte vendor dhe ndërkombëtar të angazhuar nga IKAP.

7. PËRFUNDIM

IKAP ka dëshmuar se përmes përkushtimit, partneriteteve strategjike dhe inovacioneve, mund të arrihen rezultate të qëndrueshme për fuqizimin e administratës publike. IKAP mbetet një faktor kyç në procesin e reformës së administratës publike në Kosovë, duke ndërtuar një bazë të qëndrueshme për profesionalizimin e mëtejshëm të shërbimit civil dhe administratës publike në përgjithësi.

Raporti i Performancës dorëzohet tek Njësia Përgjegjëse deri më 31 Mars të vitit pasardhës.


Drejtori i Agjencisë